

FJALA E DEPUTETIT FATMIR MEDIU

E ENJTE 20 TETOR 2022

Të nderuar kolegë deputetë!

Dua t'ju bashkohem të gjitha argumenteve që shtroi këtu zonja Tabaku. Pa dashur t'ju përsëris ato, dua të them se ne, si shqiptarë, kemi përballë dy çështje të mëdha: e para ka të bëjë me menaxhimin apo keqmenaxhimin e burimeve tona energjetike. Po sjell një fakt, që u përmend këtu, i cili ka nevojë për analizë: OSHEE-ja ka humbjet më të larta në Europë. Këto gjashtë vite janë investuar rreth 500 milionë dollarë, por humbjet janë ende në nivelin 21 %.

Problemi tjetër që kemi, që është pa dyshim pjesë e krizës, ka të bëjë me pasojat e luftës. Këtë nuk e ka qeveria në dorë, por të paktën ka në dorë një gjë tjetër: të analizojë dhe të kërkojë përgjegjësi të drejtuesit, përpara se t'ju kërkojë sakrifica qytetarëve shqiptarë.

Janë të shumta çështjet që kanë pikëpyetje. Sa eficiente kanë qenë investimet në sektorin energjetik? Sa nga këto prokurime kanë qenë të nevojshme dhe sa jo? A duhet të vazhdohet me prokurime, të cilat nuk shërbejnë në ngritjen e kapaciteteve energjetike, apo duhet të frenohen për t'ju shërbyer zbutjes së rritjes së çmimeve të energjisë elektrike? Sa miradministrohen këto ndërmarrje të ashtuquajtura publike, por që shpesh shndërrohen në anekse partie e në struktura politike dhe elektorale, duke humbur sensin dhe mënyrën e funksionimit të tyre në respektim të ligjit? Fakti që ERRE pranon vendimin e qeverisë në kundërshtim me ligjin, e po ashtu edhe anulimin, tregon se ERRE është strukturë në varësi të qeverisë, jo të parlamentit, jo një institucion që mbron interesin publik dhe interesin e qytetarëve, ndaj patjetër që ne, si parlamentarë, kjo duhet të na shqetësojë. Unë mendoj se e kemi të vështirë ta bëjmë këtë diskutim për faktin se edhe ky parlament, as më shumë e as më pak, është një aneks i qeverisë dhe jo e kundërta.

Sa familje ndikohen nga rritja e çmimit të energjisë elektrike? Kur qeveria shpalli vendosjen e fashës dhe llogaritjen e konsumit, tha se prekeshin 32 mijë familje, ndërkohë që në vetë analizën që u çua pranë ERRE-s, janë mbi 80 mijë familje. Pra, janë 80 mijë familje, të cilat ndikohen dhe varfërohen nga rritja e çmimit të energjisë elektrike. Ky është një problem shumë i madh për vendin tonë, duke pasur në konsideratë edhe faktin që u referohemi çmimeve dhe sezonit të shtatorit, në një kohë që nëntori e dhjetori janë muajt me konsumin më të madh dhe numri i familjeve që do të ngarkoheshin me fashën 800 do të ishte akoma më i madh.

Rruga e vetme që u ngelet shqiptarëve kur varfërohen dhe nuk kanë siguri, është të largohen nga ky vend. Kjo është drama më e madhe që po ndodh në Shqipëri: shpopullimi për shkak të varfërisë. Në lidhje me këtë duhet të mendojmë të gjithë së bashku se si duhet ta frenojmë, sepse përndryshe do të shndërrohemi në një vend tërësisht apatik, pa mundësi zhvillimi dhe pa të ardhme.

Çfarë po ndodh në Europë me energjinë?

Ndërsa çmimet europiane të gazit rriten tetë herë nga mesatarja e tyre dhjetëvjeçare, vendet e bashkimit European po prezantojnë politika për të frenuar ndikimin e rritjes së çmimeve të familjet dhe biznesi. Këto përfshijnë gjithçka, që nga subvencionet e kostos së jetesës e deri te rregullimi i çmimeve me shumicë. Në përgjithësi, financimi për nisma të tilla ka arritur në qindra miliarda dollarë.

Nga korriku i vitit 2021 deri në shtator 2022, ka pasur financime pothuajse në të gjitha vendet e Bashkimit European. Sot Gjermania ka hedhur në treg mbi 200 miliardë euro pikërisht për të ndikuar drejtpërdrejt dhe për të ndihmuar konsumatorët dhe bizneset në përballjen me rritjen e çmimit të energjisë elektrike. Italia ka hedhur 49, 5 miliardë dollarë nga korriku 2021 deri në shtator 2022. Franca ka hedhur 44, 7 miliardë dollarë. Mund të marr edhe vende të tjera, por Italia subvencionon pensionistët dhe punëtorët me një bonus prej 200 dollarësh për koston e tyre të jetesës. Gjermania 300 dollarë, Britania rreth 477 dollarë. Pra, të gjitha vendet janë përpjekur të zbusin pikërisht pasojat që bien mbi familjet dhe bizneset, që të kenë mundësi që ekonomia të zhvillohet, por po ashtu edhe familjet të mos përballen me kriza të tilla, të cilat varfërojnë ekonominë familjare dhe shkaktojnë kriza akoma më të mëdha.

E gjithë Europa është në krizë dhe këtë duhet ta kuptojmë. Mbi 40 % të nevojave të Europës për gaz përbushen nga Rusia, por mësimi që ka marrë sot Europa, që duhet ta lexojmë drejt edhe ne, është se dekada të diplomacisë energjetike mund të zhduken me një pushtim brutal si ai që Rusia i bëri Ukrainës. Përpjekjet deri në naivitet për të tërhequr Rusinë nga vendet e Bashkimit European, për ta bërë atë pjesë të klubit të vendeve perëndimore nuk funksionuan. E kundërta ndodhi. Kremli, nëpërmjet parave që vinin nga energjia, u shndërrua në një nga kërcënimet më të mëdha në pikëpamjen ushtarake, gjë që e tregoi realisht me sulmin brutal dhe agresionin ndaj Ukrainës. Prandaj, është e domosdoshme, dhe ky është përfundimi, që në një kohë sa më të shpejtë sistemet europiane të energjisë të transformohen, që të funksionojnë pa ndihmën e naftës dhe të gazit të Rusisë. Ky ndryshim është i paprecedentë dhe nuk do të jetë i lirë, por brenda kësaj mundësie duhet të shikojmë edhe ne si vend: me çfarë problemesh përballemi? Si duhet ta diversifikojmë dhe çfarë duhet të bëjmë në vendin tonë për energjinë? Shqipëria nuk ka ndonjë varësi nga gazi rus, por pa dyshim, për sa kohë që ne importojmë gaz, çmimet dhe kostot për këtë arsye janë të larta dhe bien në kurriz të qytetarëve shqiptarë.

I thashë këto sepse është e nevojshme të kuptojmë se deri tani ne kemi paguar rreth 500 milionë për të blerë energji në treg, për të importuar. Prandaj, është mirë të mos mendojmë vetëm në terma afatshkurtër se çfarë do të bëjmë, por në terma afatgjatë.

Së pari, diversifikimi i burimeve energjetike është i domosdoshëm. Kjo krizë do të jetë afatgjatë, ndaj ne duhet të investojmë sot, në mënyrë që të parandalojmë pasojat, të cilat nuk janë vetëm ekonomike.

Së dyti, sot më shumë se kurrë provohet se sa të drejta ishin politikat e ndjekura nga qeveria "Berisha" për ndërtimin e HEC-eve me investime private, të cilat sot janë bërë domosdoshmëri në kompensimin e problemeve që vijnë nga mungesa e energjisë.

Do të them edhe disa gjëra të tjera. Për sa i përket TAP-it, duhet ta vlerësojmë, por duhet të shikojmë edhe në interes gjeopolitik në lidhje me nivelin verior të transmetimit të energjisë dhe të gazit me IAP-in.

Po ashtu, është e rëndësishme që kompani të tilla si *Exxon Mobile* dhe *Exxelerate Energy* të fillojnë të funksionojnë në një marrëdhënie sa më të shpejtë dhe të drejtpërdrejtë dhe këtu duhet patjetër që qeveria ta përshpejtojë procesin. Ne kemi nevojë për investime amerikane, por më shumë nevojë kemi për investime të drejta.

Ato *floating terminals*, të cilat duhen ndërtuar, ashtu siç ka bërë Gjermania dhe Kroacia, janë një nevojë jetike jona, pse jo edhe energjia atomike. Kur u tha atëherë u duk si një shaka, por sot ka ardhur koha, sepse ka teknologji të tilla, të cilat jo vetëm që nuk kanë nevojë për sipërfaqe të madhe, por garantojnë të gjithë elementet e sigurisë dhe Shqipëria mund të bëhet jo vetëm një vend ku investohet, por edhe një

vend, i cili mund ta ekspertojë energjinë elektrike, në qoftë se ne marrim investimet dhe teknologjinë e duhur.

Dua ta mbyll diskutimin tim me nevojën që për çështjen e energjisë dhe të sigurisë ne të ulemi të gjithë së bashku si deputetë, jo vetëm të dëgjojmë se çfarë thotë qeveria, si dhe të arrijmë në një kuptim të drejtë të kostove, të problemit, të çështjeve që lidhen me energjinë. Energjia nuk është vetëm ekonomi, energjia është çështje sigurie dhe kjo duhet të na preokupojë që të gjithëve për të arritur në një qëndrim të përbashkët dhe sa më afatgjatë. Faleminderit!